



National Council for Economic
Development

Modele të masave të propozuara për Qeverinë e Kosovës – të menjëhershme dhe afatmesme për sektorin privat në Kosovë

Prishtinë, 27 Mars, 2020

The Secretariat – National Council for Economic Development

Supported by EBRD

Përshkrimi i situatës

Përhapja e vvirusit Covid-19 do ta ndikojë ekonominë e globale që do të përballet me një paqëndrueshmëri apo shfuqizim historik të tregut, përkatësisht Kosova pritet të përballet me ndikim jo të lehtë në ekonominë e saj të brishtë. Meqë implikimet e kësaj pandemie po rriten çdo ditë, perspektivat e këtij dokumenti mund të ndryshojnë shpejtë që ta ndikojnë sektorin privat të shtetit të Kosovës. Brenda afatit kohor, prej më shumë se dy javë, Kosova ka 94 raste të konfirmuara të personave të prekur nga Covid19, janë vendosur kufizime nga Qeveria e Kosovës, si në shumë vende të tjera të prekura, ashtu siç është kufizimi i lëvizjes së individëve brenda vendit në minimum, ndërsa lëvizja përtej kufijve është ndaluar. Kufijtë mbesin të hapur për importet dhe eksportet e mallrave dhe furnizimeve thelbësore në masën e mundur. Për më tepër, paqëndrueshmëria politike ka shtuar një element të pasigurisë në perspektivën e vendit.

Sa i përket EC-Komisionit Evropian në Kosovë, më 25 mars 2020, u zotuan për: të paktën €5 milion për nevoja të menjëhershme; €50 milion për të lehtësuar ndikimin socio-ekonomik; dhe deri në €13 milion për të mbështetur Buxhetin e Kosovës.

WB - Banka Botërore dhe Bordi i Drejtorëve të IFC- Korporata Financiare Ndërkombëtare kanë aprovuar një paketë të shpejtë financimi prej \$14 miliardë për të ndihmuar bizneset dhe vendet në përpjekjet e tyre për të parandaluar, diagnostifikuar dhe trajtuar përhapjen e shpejtë të COVID-19.

Nga \$14 miliardë, \$8 miliardë dollarë janë për sektorin privat, ndërsa \$6 miliardë janë për sektorin publik.

Gjatë këtyre kohërave të ndryshueshme, më poshtë mund të gjeni masa që duhen të konsiderohen nga shteti i Kosovës, të ndara në dy kategori: masat për konsiderim të menjëhershëm dhe ato për konsiderim afatmesëm.

Modele të masave për shqyrtim të menjëhershëm

Masat e propozuara për zbatim të menjëhershëm janë të renditura si mëposhtë:

1. Prodhimi në Kosovë – Qeveria e Kosovës duhet të identifikojë ndërmarrjet prodhuese, veçanërisht ato që prodhojnë pajisje mjekësore dhe të bashkëpunojnë me donator, të cilët janë të gatshëm të ofrojnë mbështetje, për të siguruar ri-përcaktimin e kapaciteteve të tyre prodhuese drejt materialeve dhe pajisjet e nevojshme. Kompanitë e mëdha prodhuese, të cilat tashmë kanë filluar të punojnë në prodhimin e maskave, rrobave mjekësore dhe më e rëndësishmja dorëzave mjekësore, janë këto:


- [ArtaTex 1](#) – tashmë ka filluar procesin e prodhimit të maskave dhe do të fillojë prodhimin e rrobave;
- [PUNTEX](#) – tashmë kanë filluar procesin e prodhimit të maskave;
- [Ultra Cosmetics](#) – kanë kapacitete për të prodhuar dorëza që mund të përdoren në veprime të caktuara mjekësore;
- [Eximtex-Jatex](#) – tashmë kanë filluar procesin e prodhimit të maskave, dhe kapaciteti i tyre aktual i prodhimit është 2500 maska në ditë.
- [Mask.Me](#) – një bashkëpunim midis dy ndërmarrjeve inovative, [Te Pema](#) dhe [Formon](#), ka rezultuar në një sipërmarrje që prodhon maska që i përmbahen standardeve të OBSH dhe KB. Ata aktualisht janë duke prodhuar me kapacitet të plotë dhe kanë bashkëpunuar me institucionet e Kosovës, duke dhuruar donacion një numër të maskave për Institutin për Shëndetin Publik. Për më tepër, Formon, një kompani që prodhon printera 3-D janë duke punuar në drejtim të përmirësimit të efikasitetit dhe përdorueshmërisë së respiratorëve.

Qeveria e Kosovës duhet të identifikojë kompanitë vendore farmaceutike dhe të bashkëpunojë me donatorët që janë të gatshëm të ofrojnë mbështetje, për të siguruar ri-përcaktimin e kapaciteteve të tyre prodhuese drejt produkteve të nevojshme farmaceutike në këtë kohë. Prodhimi kryesor duhet të përqendrohet në acetaminofen, vitaminë c, azitromicinë dhe produkte të tjerë farmaceutikë të identifikuar si kritike për pandeminë COVID-19. Kompanitë kryesore farmaceutike janë këto:

- [TrePharm](#);
 - [GentiPharm](#).
- 2. Produktet Emergjente** – Qeveria e Kosovës duhet të konsiderojë krijimin e një linje të kredisë për ndihmë emergjente për bizneset që operojnë në sektorët esencial:
- Prodhuesit lokal që prodhojnë ushqim dhe pije thelbësore:
 - Ujë, miell, bukë, qumësht, vaj;
 - Prodhuesit lokal që prodhojnë pajisje mjekësore:
 - Të tilla si maska, rroba mjekësore dhe dorëza;
 - Prodhuesit lokal që prodhojnë artikuj farmaceutikë.
- 3. Testimi – Covid-19** - Qeveria e Kosovës, nën drejtimin e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet të konsiderojë krijimin e një linje buxhetore të ndihmës emergjente të dedikuar për blerjen e një numri të konsiderueshëm të testeve për Covid-19 për përdorim në shtëpi për të siguruar që rritet numri i testimeve të popullatës. Nëse është e mundur, këto teste mund të ofrohen falas ose me një çmim të përbalueshëm për përdorim vetanak.
- 4. Kthimi i kredive pa interes** – Qeveria e Kosovës duhet t'i propozojë Bankës Qendrore të Kosovës zbatimin e një pezullimi prej tre muajve, pa interes (ose në rrethanat më të mira vetëm duke i llogaritur tarifën e mirëmbajtjes së kredisë të cilat përfshihen), e pagesave të kredive për të gjithë individët dhe bizneset që janë në proces të shlyerjes së këtyre kredive. Kjo masë duhet të jetë e zbatueshme për të gjitha institucionet financiare: bankat, mikro-financat etj.
- Kjo do t'i lehtësonte bizneset dhe individët nga shlyerja e kredisë, duke pasur parasysh situatën aktuale të "pauzës" ekonomike;
 - Një masë e tillë duhet të ofrohet specifikisht për bizneset esenciale për vazhdimin e zinxhirit të furnizimit. Më poshtë është një ndarje e kredive sipas sektorit dhe maturimit;

- Siç shihet, bizneset që operojnë në tregti si dhe shitje me pakicë përbëjnë numrin më të madh të kredi marrësve. Brenda këtij sektori shitësit me pakicë që operojnë në industrinë e ushqimit dhe pijeve janë ende pjesërisht funksionale gjatë kohës së bllokimit, megjithatë, ky sektor është një nga më të ndjeshmit në ekonominë e Kosovës, prandaj dhe mbështetja për sa i përket ri-pagimit të kredisë bankare është më se e nevojshme për këtë sektor.

Figura 1: Kreditë sipas Sektorëve specifike në miliona EUR, sipas maturimit, janar 2020



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

- 5. Masat e ri-programimit të kredisë** - Nëse masat e izolimit COVID-19 vazhdojnë për më gjatë, Qeveria e Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës së bashku me bankat komerciale në Kosovë duhet të konsiderojnë masat e ri-programimit të kredive, veçanërisht për bizneset dhe individët që janë prekur më së shumti nga masat. Kjo duhet të aplikohet për të paktën tre muaj pas situatës emergjente.
- 6. Shtyerja e përmbushjes së obligimeve tatimore** - Rekomandohet që Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave dhe Transfereve të shtyjnjë mbledhjen e tatimeve të brendshme që i grumbullon ATK (TVSH-ja e brendshme, tatimi në të ardhura personale, tatimi në të ardhura të korporatave, dhe tatimin në qira) për

tremujorin e dytë të vitit 2020 për të gjitha kompanitë deri në fund të vitit 2020. Kjo do t'i japë sektorit privat dhe personave privat hapësirë, edhe nëse izolomi do të përfundojë përpara afatit.

7. **Lirimi i Importit** – Ministria e Financave dhe Transfereve duhet të zgjasë vlefshmërinë e vendimeve të marra për përjashtime nga importi nga Komisioni për Lirimin e Importeve, me qëllim të zbatimit të nenit 29 të ligjit Nr. 05 / L-037 për taksën e vlerës së shtuar dhe neni 48 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për Zbatimin e Ligjit Nr. 05 / L-037 për Taksën e Vlerës së Shtuar, bazuar në autorizimet e marra me Vendimet e Qeverisë 13/07 & 14/07 të datës 06.10.2017, deri në fund të Qershorit 2020. Një gjë e tillë do t'ju lehtësonte bizneseve prodhuese të vazhdojnë të funksionimin normal gjatë kësaj periudhe.
8. **Subvencionimi i Pagave** – Qeveria e Kosovës duhet të merr parasysh kërkesat nga sektori privat, dhe të merr parasysh skemat e mundshme të subvencionimit, për një kohë të kufizuar, të pagave të punonjësve të bizneseve që nuk janë operacionale për momentin, për një shumë fikse të 30-50% të pagës bruto, apo të barabartë me pagën minimale. Përmes një skeme të tillë, Qeveria do të ndërhynte si nga ana e ofertës ashtu edhe nga ana e kërkesës në ekonomi. Duke i ofruar lehtësim bizneseve jo-operuese, derisa në të njëjtën kohë duke vazhduar një linjë të hyrjes së parave të gatshme (duke mbajtur gjallë kështu kërkesën për mallra dhe shërbime) për familjet që janë të punësuar në këto firma në sektorin privat.

Ekzistojnë dy mundësi që Qeveria e Kosovës të merr hua për fonde për një periudhë dy vjeçare. Këshillohet që të shfrytëzohet Fondi i Kursimeve Pensionale ose Fondi Kosovar për Privatizim. Fondet mund të huazohen me të njëjtën normë interesi si atë të fundit të aplikueshëm për pjesën e mbetur të njërës prej këtyre fondeve.

9. **Ri-programimi i Qirasë** – Qeveria e Kosovës duhet të merr në konsideratë marrjen e masave në lidhje me pagesat e qirave, si për bizneset ashtu edhe për individët. Një masë e ri-programimit, e cila siguron të mos ketë asnjë dëbim deri në fund të muajit qershor 2020, është e mundur dhe do të ulë ndjeshëm kostot operacionale të bizneseve që operojnë në Kosovë. Sidoqoftë, kjo masë duhet të sigurojë që ri-pagimi i qirasë së papaguar të ri-programohet që të përfundojë deri në një datë të caktuar, siç është në kohën e gjashtë muajve, për shembull në fund të muajit dhjetor 2020. Kjo

masë do të ishte e zbatueshme për kontratat që janë noterizuar apo përfunduar më së largu në fund të shkurtit 2020.

Modele të masave për shqyrtim afatmesëm

Masat afatmesme për tu konsideruar i gjeni të renditura më poshtë:

1. **Stimuj Fiskal të Targetuar** - Qeveria e Kosovës, posaçërisht Ministria e Financave dhe Transfereve, duhet të hartojë një pako stimuluese fiskale të planifikuar mirë dhe të targetuar e cila do të miratohet pas përfundimit të krizës pandemike në Kosovë:
 - a. Pakoja duhet të planifikojë transfere nga Qeveria e Kosovës në sektorë dhe biznese që kanë ngecur gjatë periudhës së izolimit.
2. **Linja e Buxhetit Shëndetësor** – Gjatë procedurës së rishikimit të buxhetit, Qeveria e Kosovës duhet të konsiderojë rishikimin e linjave buxhetore për t'i shërbyer më mirë situatës së Kosovës për momentin. Kjo përfshin rritjen e shpenzimeve për qëllime mjekësore dhe që direkt kontribuon shkurtimin e periudhës kufizuese si dhe në mbështetje të ekonomisë.
3. **Rikonstruktimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore** - Qeveria e Kosovës gjithashtu duhet të vë në dispozicion për mbështetjen substanciale të sektorit privat një Program të Disponueshmërisë së Kredive, fonde të cilat mund të ofrojnë mbështetje për bizneset që kanë ngecje në rrjedhën e parasë dhe rimëkëmbjen pas izolimit. Një hap i mundshëm mund të jetë konsiderimi i ristrukturimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, për të siguruar mbështetje për bizneset që preken më shumë nga pandemia.
 - a. Prioritet në këtë skemë, duhet t'u jepet bizneseve dhe sektorëve, bazuar jo vetëm në kontributin e tyre në BPV ose nivelet e eksportit, por më e rëndësishmja, bazuar në numrin e punëtorëve që punësojnë. Statistikat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se sektorët thelbësorë, në prodhimin e ushqimit dhe pijeve, punësojnë rreth 20,000 punëtorë aktualisht.¹
4. **Rënia e Remitancave** - Duke pasur parasysh që dërgesat e drejtpërdrejta nga diaspora përbëjnë rreth 12% të PBB-së vjetore të Kosovës (vitin e kaluar, Kosova

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Tregut të Punës, 2019.

pranoi €852 milion në dërgesa²), hezitimi për të udhëtuar, i kombinuar me rënien ekonomike të shkaktuar nga pandemia COVID-19 në ekonomitë perëndimore, do të ketë ndikim të konsiderueshëm në ekonominë e Kosovës. Meqenëse pjesa më e madhe e dërgesave kanë shkuar drejt konsumit në vitet e kaluara, ekonomia e Kosovës do të pësojë një rënie të kërkesës për mallra dhe shërbime në gjysmën e dytë të vitit. Qeveria e Kosovës duhet të parashikojë ndikimin e kësaj rënie dhe të konsiderojë mjetet e injektimit të rrjedhës së parave në ekonomi, ose përmes uljes së niveleve të kredisë për konsum, ose përmes transferimeve të drejtpërdrejta në ekonomi.

5. **Linja të Jashtme për Huamarrje** - Duke pasur parasysh se raporti i borxhit publik me BPV-në në Kosovë mbetet ende i ulët, Qeveria e Kosovës mund të përdorë huamarrjen nga Korporatat Ndërkombëtare Financiare për të konsoliduar më tutje mundësitë e financimit.
 - a. Qeveria e Kosovës duhet të negociojë një linjë të përgjithshme të huamarrjes nga Grupi i Bankës Botërore;
 - b. Qeveria e Kosovës duhet të konsiderojë negocimin e huamarrjes së investimeve kapitale me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
 - c. Pas rishikimit të buxhetit dhe ri-përcaktimit të linjave buxhetore drejt një pakoje stimuluese fiskale, Qeveria e Kosovës duhet të konsiderojë negocimin e një kredie nga FMN për të siguruar stabilitetin makro-fiskal.

² Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës; Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës 2019.

Rekomandimet nga përfaqësuesit e sektorit privat

Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, Këshilli i Investitorëve Evropianë, Klubi i Prodhuesve të Kosovës

1. Vlerësimi i masave fillestare parandaluese kundër përhapjes së virusit COVID-19

Si rrjedhojë e vendimeve të para të Qeverisë për kufizimin e veprimtarive ekonomike, vështirësi janë raportuar gati nga të gjitha ndërmarrjet private që operojnë në sektorë të ndryshëm, me theks të veçantë në sektorin e hoteleve, restoranteve dhe kafiterive, për shkak të ndalimit të punës, por edhe të sektorit të agjencive turistike. Kompanitë kanë raportuar për rritje enorme të kërkesës për produkte të caktuara, vështirësi në transportin ndërkombëtar të mallrave, ngritje të çmimeve të transportit, produkteve finale, por edhe të lëndës së parë. Po ashtu situata e krijuar pas shpalljes së pandemisë COVID-19 ka shkaktuar panik dhe çrregullim total në treg, gjë që reflektohet me rënien e menjëhershme të kërkesës për produkte dhe shërbime, rënie të pagesave të obligimeve kontraktuale dhe zvogëlim të qarkullimit të parasë. Shumë kompani kanë paralajmëruar se që në muajin prill nuk do të kenë mundësi të mbajnë punëtorët në punë dhe të vazhdojnë me pagesa, që do të rezultojë menjëherë me zvogëlim drastik të punësimit në sektorin privat.

Problemet më të mëdha janë lidhur me refuzimin e punonjësve që të paraqiten në punë, duke bazuar këtë refuzim në interpretimin e gabuar të vendimit të Qeverisë për organizimin e punës nga shtëpia aty ku kjo është e mundur, por edhe për shkak të presionit të familjarëve. Ankesat tjera janë lidhur edhe me ndërhyrjet e trupave inspektuese. Në disa raste, inspektorët kanë vënë shirita rrethues (për ndalimin e qasjes) në raftet e produkteve jo-ushqimore dhe jo-higjienike, në kundërshtim të qartë me vendimin e qeverisë. Probleme në ditën e parë të zbatimit të vendimit janë paraqitur edhe për sa i përket ndalesës së hyrjes së shtetasve të huaj, që afektonte kompanitë e transportit, respektivisht automjetet transportuese të drejtuara nga shtetasit e huaj, gjë që ka krijuar probleme në furnizimet me mallra. Ky është problem i veçantë kur dihet se konsumi në Kosovë në masë shumë të madhe varet nga produktet e importit. Ndërsa ndalimi i transportit ndërrurban ka penguar dhe transportin e punonjësve nga vendbanimet e tyre në vendet e punës, por edhe transportin e brendshëm të organizuar ose kontraktuar nga vetë kompanitë.

Po ashtu, propozimet e paralajmëruara nga Qeveria e Kosovës të dielën, më datë 15 mars 2020 kanë krijuar huti dhe interpretime të gabuara për sa i përket shtyrjes së pagesës së kësteve të kredive, pagesës së shërbimeve të furnizimit me ujë, rrymë, internet, dhe televizor kabllor, por edhe shtyrjes së detyrimit për deklarim dhe pagesë të tatimeve të ndryshme, ashtu si dhe raporteve financiare. Operatorët ekonomikë, ofertues të shërbimeve të sipër cekura, kanë raportuar për rënie drastike të pagesave që në ditën e parë, për shkak të perceptimit të krijuar se konsumatorët janë liruar nga pagesa e këtyre shërbimeve. Duke pasur parasysh vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare se kriza aktuale e lidhur me pandeminë COVID-19 pritet të arrijë kulminacionin për 10-14 javë, atëherë pritjet reale janë se bllokimi shoqëror dhe ekonomik do të mbetet realitet për së paku 3-4 muajt e ardhshëm, Qeveria duhet të zhvillojë me urgjencë masa adekuate për përkrahjen e sektorit privat në Kosovë. Duke pasur parasysh fragjilitetin e bizneseve private dhe mungesës së likuiditetit, kriza e shkaktuar nga COVID-19 do të rezultojë me bankrotimin e shumë bizneseve dhe shkatërrimin e zinxhirëve të vlerës dhe vendeve të punës. Një gjë e tillë do të rezultojë me shkatërrimin e bazës ekonomike të Kosovës dhe do të kthejë Kosovën shumë vite mbrapa.

Për këtë arsye, përfaqësuesit e sektorit privat ofrojnë sugjerimet për masat Qeveritare për përkrahjen e sektorit privat, ashtu që ndikimi i krizës të mitigohet sa më shumë që është e mundur. Sektori privat mendon se masat e propozuar duhet të jetësohen pavarësisht zhvillimeve politike, krahas angazhimit aktiv në sektorin shëndetësor.

Përfaqësuesit e sektorit privat, i sugjerojnë Qeverisë së Kosovës të zotohet se:

1. Të dalë me deklaratë publike duke shprehur mbështetjen për masat e propozuara me qëllim të largimit të panikut nga tregu dhe shprehjes së mbështetjes publike nga Qeveria për sektorin privat me synim të kthimit sadopak të normalitetit në treg;
2. Do të ndër marrë të gjitha masat që sigurojnë likuiditetin e mjaftueshëm në sistemin ekonomik të vendit, si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat;
3. Do të përkushtohet që në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues të sektorit privat dhe ekspertë të fushës, brenda shtatë ditëve të ardhshme të zhvillohet një program i detajuar i pakos stimuluese financiare për mbështetjen e sektorit privat;

4. Të shqyrtojë burimet vetanake për financim të pjesërishëm të masave të prezantuar në vijim (Fondi i Privatizimit, Rezervat Buxhetore);
5. Të sigurohet se ky program i mbështetjes qeveritare do të arrijë synimin e minimizimit të dëmeve në ekonominë e vendit dhe ruajtjen e një numri sa më të madh të bizneseve dhe vendeve të punës që ato mbështesin;
6. Të punojë me Institucionet Financiare Ndërkombëtare për strukturimin e financimit të këtij programi stimulues për sektorin privat në Kosovë.

Propozimet e masave në mbështetje të sektorit privat dhe ekonomisë së vendit:

Nr.	Masat e propozuara	Pikat e intervenimit	Institucioni përgjegjës
1	Qartësimi i të gjitha vendimeve të Qeverisë	Vendim shpjegues publik	Qeveria
2	Marrja e vendimeve për shtyrjen e afateve për deklarimet tatimore si në KKRF ashtu edhe në ATK si dhe shtyrjen për një kuartal të obligimit për pagesat e tatimeve në ATK (përfshirë tatimin në të ardhurat e korporatave, tatimin mbi vlerën e shtuar, si dhe tatimin në të ardhura personale)	Vendime administrative	Ministria e Financave dhe Transfereve
3	Marrja e vendimeve për shtyrje e afatit për raportime vjetore për tre muaj	Vendime administrative	Ministria e Financave dhe Transfereve (për raportet e dorëzuara në KKRF) Ministria e Punëve të Brendshme (për raportet e dorëzuara në Zyrën e OJQ-së)
4	Shfuqizimi i menjëhershëm i vendimit të Ministrisë së Financave për pezullimin e përkohshëm të të gjitha kërkesave ndaj Thesarit për rimbursime për personat fizikë dhe	Plotësimi-ndryshim i vendimeve të para	Ministria e Financave dhe Transfereve

	juridikë, si dhe pagesat e të gjitha obligimeve financiare qeveritare ndaj furnitorëve privatë – si dhe ekzekutimi i menjëhershëm i detyrimeve nga thesari të punë kryesit e kontraktuar për punët dhe shërbimet e dorëzuara.		
5	Draftimi i një programi për mbështetjen dhe stimulimin e sektorit privat do të përfshijë një pako financiare, shuma e saktë e së cilës do të specifikohet në programin e detajuar mbështetës, rreth 5% të bruto produktit vendor të Kosovës për e vlefshme deri në fund të vitit 2020, e ndarë në dy faza (emergjente dhe faza e rimëkëmbjes), e cila do të shërbejë për: (1) Ofrimin e subvencioneve për bizneset për mbulimin e obligimeve operacionale, përfshirë pagesën e pagave, qirave dhe shpenzimeve operative, (2) Shtimin e kapitalit dhe zhvillimin e produkteve financiare të reja të ofruara nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë, të cilat duhet të përdoren nga Bankat Komerciale në Kosovë për ofrimin e likuiditetit shtesë përmes produkteve kreditore për bizneset në Kosovë, (3) Zhvillimin e masave të tjera për stimulimin e funksionimit të zinxhirëve të vlerës në sektorët e ndryshëm të ekonomisë.	Dokument programor	Qeveria e Republikës së Kosovës Ministritë e linjës Fondi Kosovar për Garantimin Kreditor Asociacionet e biznesit Shoqata e Bankave të Kosovës
6	Draftimi i një njoftimi shpjegues publik për vendimin e Bankës Qendrore të Kosovës, për aprovimin detyrimor të të gjitha kërkesave të bizneseve për shtyrje të kësteve të pagesave të	Vendim shpjegues publik	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

	kredive dhe ristrukturim të obligimeve kreditore në mënyre standarde për të gjitha bankat		
7	Të kërkohet heqja e kufizimeve në tërheqjen e parasë së gatshme nga llogaritë në bankat komerciale, sidomos për Institucionet financiare jo bankare, posaçërisht ato që merren me transfere të parasë për të liruar hyrjen e dërgesave në Kosovës.	Vendim shpjegues publik	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
8	Shfuqizimi i vendimeve të autoriteteve komunale për mbyllje të bizneseve	Urdhëresë administrative	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
9	Krijimi i një portali për publikim të të gjitha vendimeve dhe njoftimeve që lidhen me masat parandaluese kundër COVID-19	Vendim	Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti i Administratës Publike, në koordinim me kompanitë nga sektori i teknologjisë së informacionit
10	Qeveria të krijojë një fond të mbështetjes së menjëhershme direkte për ndërmarrjet dhe punonjësit e ndërmarrjeve, aktiviteti i të cilave është ndërprerë, ose afektuar rëndë, pas ndërmarrjes së masave parandaluese për përhapjen e virusit COVID-19. Qeveria merr përsipër të zhvillojë programin e mbështetjes së sektorit privat brenda një periudhe shtatë ditore dhe të fillojë zbatimin e tij më së largu deri në fillim të muajit prill 2020.	Vendim	MEPTINIS Qeveria

Oda Ekonomike e Kosovës

Anëtarësia e Odës Ekonomike të Kosovës për Qeverinë e Republikës së Kosovës kërkon urgjentisht të ndërmerren disa nga veprimet e listuara si më poshtë:

1. Të sigurohen pagat nga Qeveria për sektorin privat, për të gjitha bizneset, të cilave Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin numër 01/07 të datës 11.03.2020 dhe vendimet tjera pasuese ua ka ndërprerë veprimtarinë e tyre afariste, dhe këto biznese nuk mund të sigurojnë më të hyra për pagat e të punësuarve në sektorin privat. Pagat e punëtorëve të sektorit privat të paguhen në bazë të listës së pagave të të punësuarve të realizuara nga muaji paraprak përmes ATK-Trusti.
2. Të kompensohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës shpenzimet e qirasë së objekteve, zyrave, depove, etj. të sektorit privat derisa të ndryshohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për të filluar puna normale.
3. Të paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës tatimi në fitim, për kuartalin e parë (TM1) dhe obligimet tatimore për sektorin privat, derisa të ndryshohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për të filluar puna normale.
4. Të merret vendim nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shtyrjen e afatit të raportimit financiar në Këshillin për raportim financiar të Republikës së Kosovës në afat prej 3 muajve.
5. Të prolongohen obligimet e kësteve të kredive për sektorin privat në afatin kohor prej tre (3) muajve, duke filluar nga data 1 prill 2020, deri më datën 1 korrik 2020.
6. Të zgjatet me automatizëm afati i licencave të operimit, për të gjitha licencat të cilave u ka skaduar afati, deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër.
7. Të lirohen nga pagesat operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve me rastin e vazhdimit të rendeve të udhëtimit nga MIA dhe të subvencionohen nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës regjistrimi i automjeteve transportuese për bartjen e udhëtarëve, mallrave, si dhe makineritë e pajisjet tjera të sektorit privat, si dhe të lirohet nga akciza për derivate të naftës gjatë kohës sa zgjasin masat e Qeverisë.
8. Të hiqet Vendimi administrativ i kufizimit në tërheqjen e parasë së gatshme nga llogaritë bankare komerciale e sidomos për institucionet financiare jo bankare nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Oda e Afarizmit të Kosovës

Rekomandimet e sugjeruara nga Oda e Afarizmit të Kosovës janë të renditura më poshtë:

1. Subvencionimi i pagave të punëtorëve të sektorit privat për një periudhë prej 3 muajsh, në shumën prej 50% të pagave aktuale për sektorët që kanë ndaluar punën dhe ata që kanë ulur stafin;
2. Shtyrja e pagesave të kredisë për një periudhë 3 mujore (kësti i kredisë për prill të paguhet në korrik);
3. Vendosja e një linje të veçantë buxhetore për të mbështetur bizneset në nevojë që të kryejnë detyrime tregtare si shkak i Covid - 19;
4. Shteti duhet të krijojë një fond të rikuperimit të grantit / kredisë për kompanitë e prekura nga kriza si pasojë e COVID-19.
5. Sugjerimi i bankave tregtare për të siguruar kredi për bizneset me normë interesi shumë më të përballueshme;
6. Bizneset e prekura si rezultat i Covid-19 të lirohen nga tatimi në pronë, qira dhe paga për periudhën 3 muaj.
7. Mbështetja e bizneseve të vendosura në objekte publike ose private, sektorë që nuk kanë operuar ose zvogëluar aftësinë e tyre të punës duke pezulluar krejtësisht pagesat e qirave për periudhën 3 mujore ose duke zvogëluar shumën në 50% të qirasë, me pagesat e papaguara të qirasë deri në fund të dhjetorit, 2020;
8. Rritja e buxhetit për bujqësinë në mënyrë që të rritet prodhimi vendor.

Masa të tjera:

1. Ulja e pagave të parlamentarëve të Kuvendit të Kosovës me 50%;
2. Ulja e pagave në administratën publike me 50% (paga nuk duhet të jetë më e vogël se 220 €);
3. Ulja e pagave në ndërmarrjet publike me 50% (paga nuk duhet të jetë më e vogël se 220 €);
4. Sektorët e urgjencës që kanë angazhime shtesë në këtë periudhë të përjashtohen nga këto masa (ushtria, policia, shëndetësia dhe zjarrfikësit);

Rrjeti i Shitësve me Pakicë

Rekomandime për Ministrinë e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Sipërmarrjes dhe Investimeve Strategjike:

1. Afati për përmbushjen e obligimeve tatimore të shtyhet për 3 muaj
2. Banka Qendrore e Kosovës në konsultim me bankat të zgjasë afatin e kryerjes së obligimeve për 3 muaj. Sigurisht të bëhet ri-programimi i kredive. Afati i 30 prill 2020 është shumë i shkurtër duke marrë për bazë në gjendjen në të cilën ndodhemi.
3. Nëse gjendja stabilizohet për 2 javë, bizneseve do t'ju duhet patjetër edhe 2-3 muaj kohë për t'u stabilizuar me shitjet, punëtorët, furnizimin, dhe rikthimin në normalitet. Gjë e cila prap do të bartë në vete shpenzime shtesë ndërsa shitja dhe inkasimet do të jenë minimale.
4. Duke ditur që bankat kanë likuiditet, 3 muaj përkrahje e bizneseve duke shtyrë afatin e pagesave të kredive është ndihmesë dhe lehtësim për situatën e krijuar.
5. Po ashtu, shtyrja e pagesave të kredive duhet të bëhet pa pasur nevojën e aprovimit.
6. Të krijohet një plan i garancisë financiare për pagat e të gjithë punonjësve në territorin e Republikës së Kosovës. Bizneset të cilat nuk operojnë sipas vendimit të qeverisë do të kenë të pamundur të sigurojnë pagat e të punësuarve. Gjithashtu, ky plan duhet të parasheh dhe për të punësuarit nga zonat e izoluara të cilët nuk mund të kontribuojnë në vendet e punës.
7. Të themelohet një fond për sipërmarrjet private i cili do të ofronte injektive monetare pa-kthim për biznese në mënyrë që të ju mundësojë të dalin nga situatë dhe të rimëkëmben pas periudhës së përhapjes me Covid-19. Shqipëria ka filluar planifikimin në këtë drejtim ndërsa SHBA gjatë javës së ardhshme do të alokojë 1 trilionë dollarë për bizneset.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave dhe Transfereve

1. Pagë 'UNIVERSALE' të solidaritetit për punonjësit në sektorin publik dhe privat prej 289 €. Konsiderojmë që duhet të krijohet një plan i garancisë financiare për pagat e të gjithë punonjësve në Republikën e Kosovës. Përfshirë këtu edhe

personat të cilëve ju është ndalu aktiviteti apo edhe personat të cilët janë në vetizolim.

2. Pagesa e kësteve të kredive dhe obligimeve të tjera bankare të shtyhet për tre (3) muaj. Rekomandimi: Rrjeti i Shitësve me Pakicë e vlerëson lartë koordinimin ndërinstitucional në nivel qendror për shtyrjen e pagesave të kësteve të kredive deri me 30 prill 2020, marr për bazë situatën e tanishme vlerësojmë që ky afat duhet zgjatur së paku në tre (3) muaj duke vendos 0% interesin për këta 3 muaj për arsye të likuiditetit minimal dhe gjendjes kritike të bizneseve veçanërisht sektorit të retail-it. Zgjatja e periudhës për kryerjen e obligimeve bankare në tre (3) muaj ofron një mundësi që bizneset të stabilizohen me shitjet, punëtorët, furnizimin dhe rikthimin në normalitet; periudhë e cila prapë se prapë do të bartë në vete shpenzime shtesë ndërsa shitja dhe inkasimet do të jenë minimale.
3. Pezullimi i ligjit për përmbarim: Marrë për bazë dhe praktikën e vendeve të tjera të rajonit dhe për qëllime të lehtësimit ndaj bizneseve, konsiderojmë të domosdoshme që gjatë kësaj periudhe të gjendjes me përhapjen e COVID-19 tu ndalohet përmbaruesve marrja përsipër e veprimeve të përmbarimit.
4. Mbledhja e TVSH-së në brendi; Rrjeti është i vetëdijshëm për kapacitetet e limituara organizative dhe nga ana e institucioneve qeverisëse gjatë kësaj situatë emergjente të shëndetit publik, gjithsesi konsiderojmë të nevojshëm shqyrtimin e masave të cilat do të mundësonin mbledhje të TVSH-së në brendi, gjegjësisht pasi që malli është shitur, si një mundësi e cila do të garantonte likuiditet.

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës –G7

Sugjerojmë që të gjitha masat e propozuara e që kanë të bëjnë me prolongimin e obligimeve të bizneseve në raport me ATK, Dogana, Banka, të vazhdojnë në afat për 3 muaj.

Masa specifike. Duke pas parasysh numrin e vogël të bizneseve të grave dhe se ato biznese janë kryesisht mikro dhe biznese të vogla, nevojitet një trajtim i veçantë i këtyre bizneseve.

1. Pagesa e pagave për të punësuarit në këto biznese në vlerë të pagës mesatare të Kosovës;
2. Ndihmë në vlerë prej €1000 për mbulimin e kostove operative për 3 Muaj për mikrobiznese;
3. Ndihmë në vlerë prej €3000 për mbulimin e kostove operative për 3 muaj për bizneset e vogla;
4. Ndihmë në vlerë prej €4500 për mbulimin e kostove operative për 3 muaj për bizneset e mesme.

Kemi bërë një kalkulim provizor dhe kemi ardhur të vlera rreth €25 milion sa kishte me qenë kjo mbështetje direkte e Bizneseve të Grave.

Sugjerojmë që këto mjete mund të sigurohen nga 10% të buxhetit për investimet kapitale.

Ne kërkojmë nga KKZHE që të shikoj mundësinë për financim të kësaj mbështetjeje për Gratë e Kosovës nga BERZH ose Banka Botërore, apo nga cilado organizatë tjetër e cila ka për prioritet përkrahjen e grave në biznes.

Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës

1. Alokimi i 5% të PBB-së së Kosovës fondit të urgjencës dhe rikthimit në mbështetje të sektorit privat. Një paketë e tillë duhet të vihet në dispozicion për sektorin privat.
2. Paketa financiare duhet të synojë që fillimisht të mbulojë shpenzimet operacionale të bizneseve, duke përfshirë pagesat e pagave për punëtorët në nevojë, qiranë dhe shpenzimet e tjera operative.
3. Në periudhën afatmesme, paketa duhet të drejtohet drejt mbledhjes së kapitalit për sektorin privat dhe zhvillimin e produkteve të reja financiare të ofruara nga Fondi i Garancisë së Kredisë së Kosovës.

Për më tepër, Qeveria e Kosovës duhet të zhvillojë masa të tjera mbështetëse për të stimuluar funksionalitetin e zinxhirëve të vlerës në sektorë të ndryshëm të ekonomisë

Klasteri i kompanive të metalit dhe energjisë së ripërtëritshme në Kosovë

Sipas analizës në teren fushën dhe natyrën e punës së kryer nga sektori i ndërtimit, do të konsiderohet propozimi për të gjetur një zgjidhje në lidhje me sektorin "Shkuarja në punë" sipas sektorit. Duke filluar me ndërtimin, e njëjta gjë duhet të zbatohet për sektorët e tjerë që nuk rrezikojnë shëndetin e punonjësve.

Në bazë të analizës së gjendjes në terren dhe natyrës së punës që zhvillon **sektori i ndërtimtarisë**, të shqyrtohet dhe konsiderohet propozimi për ti dhënë zgjidhje "daljes në punë", gradualisht sektorë për sektorë. Duke filluar nga ndërtimtaria, e njëjta duhet të pasojë edhe në sektorë të tjerë që nuk rrezikojnë shëndetin e punëtorëve.

Konsiderojmë që duhet të analizohet edhe njëherë zhblokimi i punimeve në sektorin e ndërtimtarisë kur e dijmë se është një nga sektorët kryesorë që përbën pjesën më të madhe të investimeve dhe përbën një pjesë të madhe në buxhetin dhe GDP-në e vendit.

Aktualisht janë me qindra miliona euro projekte në ndërtim e sipër të cilat janë bllokuar dhe kjo situatë jo vetëm që është ngarkesë për investitorët por veçse ka filluar të jetë barrë e rëndë edhe për vetë buxhetin e shtetit.

Sigurisht se për këtë do të analizohet edhe gatishmëria e të punësuarve për të dale në punë në këto rrethana ku në ditë në vazhdim pritet që të ketë shtendosje të situatës sidomos pas datës 10 prill, 2020.

Duam ta theksojmë se ky sektorë gjatë punës punon me helmata, maska, dorëza dhe veshje adekuate në punë gjë që parandalon shpërndarjen e viruseve.

Forumi Ekonomik i Grave

1. Sipas ligjit të Kosovës, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor bazuar në analizën gjinore duhet të zbatohet në shpërndarjen e fondeve. Injorimi i analizës gjinore dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në këto masa të para reaguese ndaj krizës mund të ketë një efekt shumëfish të krizës në përkeqësimin e situatës për ata që janë në marginat e shoqërisë. Përdorimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe vlerësimi i ndikimit gjinor do të parandalonte pasojat e buxhetimit dhe politikave asnjane gjinore dhe do të çonte në përkeqësim të mëtutjeshëm të situatës për gratë siç është rritja e punëve të papaguar të kujdesit, dhuna në familje, etj.
2. Pasi të identifikohen kompanitë prodhuese që mund të prodhojnë materialet e nevojshme në këtë kohë, qeveria duhet të sigurohet që gratë dhe burrat që punojnë në këto ndërmarrje prodhuese janë të pajisur me produkte të duhura mbrojtëse sanitare dhe masa mbrojtëse për të shmangur ekspozimin ndaj Covid-19.
3. Rritja e numrit të testeve dhe shpërndarja e testeve duhet të marrë parasysh pabarazitë në qasje për gratë dhe burrat: në zonat rurale, me aftësi të kufizuara, të grupeve etnike minoritare; dhe të sigurojë qasje duke marrë parasysh kufizimet e transportit nën-urban për shkak të masave qeveritare.
4. Duke marrë parasysh që analizat për masat e Qeverisë janë dinamike gjithmonë në proces, rekomandojmë fuqishëm që të ato të përfshijnë nevojën për një Vlerësim të Ndikimit Gjinor për të informuar dhe udhëhequr procesin e mëtutjeshëm dhe për të planifikuar më mirë masat që duhen ndërmarrë për të adresuar nevojat e grave dhe burrave që punojnë në sektorin privat. Gratë dhe burrat përballen me qasje të ndryshme në burime financiare, të cilat duhet të merren parasysh. Kjo analizë do të sigurojë që masat do të parashikojnë sesi gratë dhe burrat do të preken ndryshe, dhe se rezultatet e këtyre masave do të përputhen me dallimet në nevojat e tyre
5. I rekomandohet Qeverisë që të mbështesë një analizë gjinore mbi ekonominë jo-formale, për të identifikuar masat praktike për të adresuar ekonominë jo-formale, derisa po ashtu rritë numrin e punonjësve të deklaruar dhe përmirëson kushtet për mbrojtjen në punë për gratë dhe burrat që aktualisht punojnë në ekonominë jo-formale.
 - a. Gratë që punojnë në ekonominë jo-formale janë më të ekspozuarat ndaj pandemisë fizikisht dhe psikologjikisht, duke marrë parasysh kompensimin e ulët financiar, mungesën e kushteve të duhura të punës, mungesën e produkteve sanitare dhe të higjienës, orët e gjata të punës dhe duke mos

- paraparë ndikimin gjinor në skemën e Qeverisë ato edhe nuk do të përfitojnë nga skemat qeveritare financiare, si subvencionimin e pagave.
- b. Hulumtimet kanë treguar që gratë në sektorin privat janë shumë të diskriminuara, konkretisht gratë që kanë paga më të ulëta dhe janë mbi moshën 40 vjeç. 54% e grave në Kosovë janë të punësuar në sektorin privat, ndërsa besohet se 30% e tyre janë të punësuar në ekonominë jo-formale dhe punojnë pa kontrata.
6. Një hulumtim i politikave i orientuar mbi ekonominë jo-formale dhe hendekun gjinor të pagave për të kuptuar më mirë pabarazitë gjinore dhe zgjidhjet specifike të politikave, si dhe veprimet për adresimin e tyre është posaçërisht i nevojshëm për të shmangur diskriminimet që mund të ndodhin gjatë vlerësimit afatmesëm dhe afatgjatë të kësaj epidemie. Kjo përfshin kuptimin më të mirë të përfshirjes së grave dhe burrave në ekonominë jo-formale në sektorin e bujqësisë. Duke marrë parasysh që gjatë këtyre kohërave të Covid-19, ngarkesa e kujdesit të papaguar për fëmijët, të moshuarit dhe anëtarët e familjes së sëmurë bie mbi gratë, ato janë kategoria me më së shumti gjasë të vuajnë nga humbja e vendeve të punës dhe / ose ulja e pagës. Qeveria duhet të sigurojë që Inspektorati i Punës do të jetë posaçërisht i vëmendshëm dhe do të rrisë kapacitetet e tij për të trajtuar raste të ngjashme.
7. Neni 22 i Kushtetutës, i cili ratifikon Konventën e Kombeve të Bashkuara për eliminimin e diskriminimit ndaj grave (CEDAW), dhe Ligji i Kosovës për Barazi Gjinore, neni 5, detyron të gjitha institucionet të ndërmarrin analiza gjinore në të gjithë sektorët; për më tepër, kërkohet analiza e ndikimit gjinor për të informuar të gjitha politikat dhe ligjet (përfshirë përgjigjen ndaj COVID). Zbatimi i kësaj analize, në kuadër të Analizës së përgjithshme të Ndikimit Rregullator, kontribuon në integrimin gjinor pasi është një nga mjetet e kësaj analize që duhet të aplikohet njëkohësisht sa herë që propozohet, hartohet, vlerësohet, etj. Për më tepër, analiza gjinore kërkohet për buxhetim të përgjegjshëm gjinor, siç e parasheh edhe Ligji i Kosovës për Barazi Gjinore. Prandaj kjo duhet të bëhet për të informuar masat afatmesme.
8. Për më tepër, duhet të sigurohet mbështetje për bizneset e udhëhequra nga gratë me masa afirmative pasi ato shpesh diskriminohen kur përpiqen të hyjnë në kredi në rrethana normale, e lëre më në kohë krize.

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Rekomandimet për veprim të menjëhershëm drejt rimëkëmbjes ekonomike:

1. Qeveria të formojë një *“task force”* të përbërë nga profesionistë të pavarur të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, të angazhuar me orar të plotë për periudhë të caktuar, të cilët do të punojnë në vlerësimin e gjendjes aktuale të ekonomisë dhe zhvillimin e një plani të rimëkëmbjes.
2. Rekomandohet që të rishikohen pagat e sektorit publik duke i'u përshtatur rrethanave aktuale. Qeveria duhet të fillojë me implementimin e rekomandimeve të FMN-së për rristurimin e administratës publike.
3. Propozohet që BQK të marrë vendim për dhënien e *“grace periudhës”* prej 6 muajve për të gjitha bizneset të cilat kanë kredi aktive në të gjitha institucionet financiare në Kosovë dhe të sigurojë që kjo nuk do të shkaktojë përlogaritje të reja të interesit nga institucionet financiare.
4. Propozohet që BQK të marrë të gjitha veprimet për të inkurajuar institucionet financiare në ofrimin e qasjes më të lehtë në financa për sektoret si prodhimi dhe bujqësia. Ndërsa për masat tashmë të marra nga BQK, rekomandohet monitorim i vazhdueshëm nga ana e BQK-së mbi zbatimin e vendimin për pezullimin e përkohshëm të pagesës së këstit të kredive aktive për një kohë të caktuar (30 Prill 2020, me mundësi të zgjatjes), duke u siguruar që bizneset të mos ngarkohen me asnjë kosto shtesë.
5. Të përgatitet analiza për industrinë të cilat kanë ndikim afatshkurtër në rimëkëmbjen e ekonomisë në Kosovë (prodhimin, bujqësinë, teknologji informative, prodhimin e energjisë), në mënyrë që përkrahja financiare të orientohet drejt tyre.
6. Të përshpejtohet procesi i shlyerjes së borxheve që Qeveria dhe Ndërmarrjet Publike kanë ndaj bizneseve në mënyrë që kjo të kontribuojë në rritjen e likuiditetit të tyre. Po ashtu: (i) të përshpejtohen edhe proceset e rimbursimeve të tatimeve direkte dhe indirekte ndaj bizneseve, dhe (ii) si masë e përkohshme për dy vitet e ardhshme, TVSH të deklarohet dhe paguhet në baza tre mujore që bizneset të kenë likuiditet më të lartë në këtë periudhë.
7. Rekomandohet që të gjitha Komunitet të analizojnë kapacitetin e tokave që mund të shfrytëzohen për bujqësi. Të kërkohet ndihmë financiare apo kredi nga partnerët strategjike, për të mbështetur programet dhe paketa investive për NMiVM dhe të cilat mund të ndihmojnë në ruajtjen e vendeve të punës në këto sektore, të japin një shtytje aktiviteteve ekonomike me të cilën do të mund të rikthehen në funksion, si dhe, të zvogëlojnë pasojat të cilat kjo krize është duke i'u imponuar.
9. Të ndryshohet qasja e Qeverisë nga një politikë e duarve larg intervenimit në vendime investive, në një qasje këshillëdhënëse. Kjo nuk do të duhej të ishte një ndërhyrje e centralizuar, por këshilla të mirë informuara duke shfrytëzuar qasjen në

informata për të ndihmuar sektorin vendor të prodhimit. Pikënisje do të duhej të ishte analiza se cilët sektorë do të mund të zëvendësonin eksportin me një kosto më të ulët të mundshme si dhe cilësinë më të përafërt të mundshme. Në anën e ndihmës financiare, këto ndërmarrje të cilat do të filtroheshin dhe do të hynin në databazën e MEPTINIS-së do të duhej të përkraheshin pa rezervë nga qeveria.

10. Asistencë tjetër për sektorin e prodhimit dhe bizneset eksportuese: lirimi nga tatimi në fitim në periudhë deri 10 vjeçare, dhe të vazhdojë politika ekzistuese e lirimit nga të gjitha detyrimet fiskale në lëndë të parë.
11. Rekomandohet krijimi i një fondi investiv përkatës i cili do të krijohej nga mjetet të destinuara për investime kapitale joproduktive (infrastrukturë/rrugë) apo edhe nga një pjesë e mjeteve nga privatizimi i ndërmarrjeve publike. Një fond i tillë i ndarë nga Qeveria do të mund nxisë interesim për mbështetje të fondit edhe prej donatorëve tjerë.
12. Aftësimi profesional do të duhej të ishte prioritet, si dhe një pjesë e fondit të orientohej në përafrimin e aftësive të fuqisë punëtore me nevojat e ndërmarrjeve në sektorin e prodhimit dhe bujqësisë.
13. Të merret në konsideratë rritja e emetimit të bonove të thesarit nga Republika e Kosovës si instrument i financimit të buxhetit. Meqenëse niveli i borxhit publik është në nivel të ultë në raport me BPV (GDP) krahasuar me vendet në rajon, atëherë mund të konsiderohet që masat për mbështetjen e ekonomisë të realizohen nga ky burim i financimit. Poashtu, Trusti Pensional i Kosovës mund të jetë si investitor potencial në këto letra me vlerë të qeverisë, meqenëse një gjë e tillë edhe është paraparë me ligj (deri 30% të drejtë investimi në Kosovë).

Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB)

Aleanca Kosovare e Bizneseve ju kërkon se pas disa masave të marra nga Qeveria, të cilat nuk janë të mjaftueshme dhe gjithëpërfshirëse me qëllim që ta mbajm fuqinë konsumuese dhe likuiditetin ekonomik ju propozon që të vazhdoni edhe me masa të tjera si vijon :

1. Rishikimi i Buxhetit me urgjencë për vitin 2020
2. Parlamenti i Kosovës duhet ta aprovoj Ligjin Emergjent për Rimëkëmbje të Ekonomisë
3. Nivelizimi i pagave në mes sektorit publik dhe privat dhe të paguhen të gjithë kontributdhënësit me pagë mesatare në nivel vendi për 3 muaj e ardhshëm pa perjashtim te asnje sektori ekonomik.
4. Subvencionimi i qirave deri në 100% jo vetëm të atyre qe kan qenë me vendime të mbyllura por edhe të atyre bizneseve që kan hasur në vështërsi të punojë përshkak masave të COVID 19
5. Të rishiqohen masat nga BQK, të shtyhen kështet e kredive për biznese dhe qytetarë pa interes dhe ndeshkime sepse Bankat Komerciale po aplikojn interes te larte deri ne 17%(per këto raste kemi argumente).
6. Të gjitha tatimet e mbledhura në brendi të shtyhen deri më 31.12.2020 dhe riprogrami i tyre të bëhet për 24 muajt e ardhshëm.
7. Energjia elektrike, uji dhe mbeturinat të subvencionohen nga shteti per 3 muajt e ardhshëm për të gjithë.
8. Të rritet vlera financiare e Fondit për Garantimin e Kredive
9. Kërkesa për burimet tjera të financimit në formë të granteve dhe kredi të buta nga Banka Botërore, kërkesa në FMN për kredimarrje nga instrumenti i shpejtë financiar, kredi nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës.
10. Hyrja e Kosovës në Borxh Publik deri ne 500 milion €, si intervenim i shpejt i qytetarëve per të mbajtur konsumin aktiv e cila e ruan likuiditetin ekonomik.
11. Të subvencionohen bizneset qe kane punuar dhe te mbeshtet bizeneset qe nuk po punojne me vendim te Qeverise qofte ne forme direkte apo në formë indirekte, transporti publik nuk funksionon dhe punëtorët kanë vështërsi për të vajtje ardhje në Punë.

Këshilli i Konsulentëve të Kosovës

Këshilli i Konsulentëve të Kosovës propozon disa projekte për bashkëpunim të cilat mund të ndihmojnë Qeverinë e Kosovës dhe kompanitë kosovare që të kalojnë këtë krizë si rrjedhojë e pandemisë Covid19.

1. Zbatimi i projekteve qeveritare për ndihmën e sektorit privat gjatë krizës aktuale të bëhet përmes konsulentëve profesional të certifikuar me certifikatën ndërkombëtare CMC (Certified Management Consultant). Aktualisht, në Kosovë janë të certifikuar 40 konsulentë të cilët kanë njohuri në fusha të ndryshme të sektorit privat dhe publik.
Përfshirja e konsulentëve menaxherial do të garantojë mbarëvajtje të fondeve publike si dhe ndikim pozitiv të këtyre fondeve. Këshilli i Konsulentëve të Biznesit do të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Transfereve për të ndarë listën dhe ekspertizën e konsulentëve profesionist.
2. Në muajin shkurt të këtij viti, Këshilli i Konsulentëve të Biznesit përmes donatorëve të ndryshëm dhe ekspert austriak, ka certifikuar 28 ekspertë vendorë për transformim digjital. Pasi proceset e digjitalizimit të operacioneve janë të domosdoshme përgjatë krizave pandemike, qeveria të përdorë ekspertizën e konsulentëve lokal në këtë fushë duke angazhuar konsulentët e certifikuar me certifikimin ekspert të transformimit Digjital, ekspert e-biznesi & Mediat Sociale, ekspert të sigurimit Kibernetik dhe mbrojtja e të dhënave, në mënyrë që të ndihmojnë institucionet e qeverisë dhe agjencionet për të menaxhuar me efikasitet këtë tranzicion.
3. Qeveria, përmes fondeve publike dhe në koordinim me donatorët, të financojë zhvillimin e platformave e-commerce për bizneset e mesme, duke mundësuar shitjen online të produkteve të ndryshme. Kjo jo vetëm kontribuon në zbutjen e problemeve ekonomike gjatë pandemisë, por edhe fuqizon sektorin privat në formë afatgjate. Implementimi i këtij projekti poashtu mund të bëhet përmes angazhimit të ekspertëve të certifikuar me certifikatën për transformim digjital (Certified Digital Transformation Expert).
4. Gjatë kësaj periudhe të pandemisë, të subvencionohen platformat e videokonferencave për bizneset e vogla dhe të mesme, agjencitë shtetërore dhe institucionet tjera të cilat evitojnë takimet direkte, duke mos çenuar afarizmin në vend. Në këtë formë, sigurohet edhe shëndeti publik por edhe vazhdimi i punëve në sektor publik dhe privat.
5. Këshilli i Konsulentëve të Biznesit (BCC), përmes ekspertëve të saj, mund të ndihmoi edhe në digjitalizimin e shpejtë të shkollave dhe universiteteve në Kosovë,

duke mundësuar vazhdimësinë e edukimit të qytetarëve të Kosovës, pa cenuar kualitetin e mësimave. Një projekt i tillë do të përfshinte pjesën harduerike dhe softuerike në të gjitha institucionet publike edukative.